



Komiteti për Politikë dhe Financa

01.Nr.II

Deçan, dt.29.03.2021

### PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e II-të të rregullt të KPF-së , me dt.29.03.2021.

Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon Natyra Kuçi) , Drejtori Urbanizmit-Ramë Melaj, Kryesuesi i Komitetit të Komuniteteve-Elmir Nezaj, Udhëheqësi i ZLK-së-Shaban Pejqinoviq, Zyrtarja për informim-Yllarta Thaqi.

Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Haki Shehaj.

Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i raportit të Ndërmarrjes “Higjiena”,
3. Shqyrtimi i propozimit për përkrahje financiare për qytetarët e Komunës së Deçanit të prekur nga Covid 19 dhe familjarët e viktimate të Covid 19,
4. Shqyrtimi i propozimit për orientimin e të hyrave të bartura të vitit 2020 në vitin 2021,
5. Shqyrtimi i Raportit finanziarë për vitin 2020,
6. Shqyrtimi i kërkesave,
7. Të ndryshme.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,

Miratohet njëzëri pa vërejtje.

1. Shqyrtimi i raportit të Ndërmarrjes “Higjiena”,

Rekomandim: Meqenëse rapporti nuk ka ardhë me shkrim, antarët e KPF-së pas një debati te shkurtër dhe konsultimeve mes vetes u pajtuan që rapporti te hiqet nga rendi i ditës se mbledhjes se kuvendit te dt.31. mars dhe i pergaditur ne shkrim te vjen ne mbledhjen e muajit prill.

2. Marrja e vendimit për përkrahje financiare për qytetarët e Komunës së Deçanit të prekur nga Covid 19 dhe familjarët e viktimate të Covid 19.

Kryesuesi- e ka prezanton piken pastaj per sqarime fjalën ia kalon drejtorit te Buxhetit, Agron Demukaj, i cili ka sqaruar se komuna e posedon listën e personave te prekur me covid 19 nga Instituti Kombëtar, mirëpo testi eshte bere edhe nga Laboratorët privat dhe ne nuk posedojmë te dhënat e tyre.

Rekomandim: KPF e shqyrtuan kete pike dhe u dakorduan qe ne kuvend ekzekutivi te përcaktohet per shumen e mjeteve qe do te ndahet per një te prekur nga Covid 19, ndërsa per rastet e vdekjes nga covid u pajtuan qe te ndahen nga 200 euro per çdo rast dhe ekzekutimi do te behet pas afatit ligjor qe vendimi do te behet i plotfuqishem ndërsa per te prekurit eshte shumë e madhe e mjeteve dhe ekzekutimi behet me ndarjen e mjeteve me rishikim te buxhetit, poashtu ne kuvend do te përcaktohen edhe modalitete tjera qe kane te bëjnë me evidentimin e personave te prekur dhe dokumentet qe duhet te prezantojnë per te vërtetuar se pacienti ka qene i prekur me covid 19.

3. Shqyrtimi i propozimit për orientimin e të hyrave të bartura të vitit 2020 në vitin 2021.

Kryesuesi- e prezanton piken pastaj e hapi debatin rrëth saj.

Kushtrim Loshaj ka kërkuar qe te prezantohen edhe marrëveshjet e bashkëpunimit per te cilat komuna ndanë mjete financiare.

Albesa Cacaj- pyet se a do te përfundojnë ndonjëherë Memorialet sepse per çdo vit ndahen mjete per kete projekt, ndërsa ne Deçan Lapidari i Salih Çekaj ka mbete pa përkujdesje.

lapidarve, per kete ma mire e dijnë gjendjen Zyra e Prokurimit mirëpo per kete mund te kërkon te na sqarojnë, mirëpo ju me nje vendim te kuvendit mund te vendosni qe Ndermarrja Higjiena te mirembane te gjithë Lapidarët e Dëshmorëve.

Mon Selmonaj- pyet te pozicioni prej 11.000 € obligim te Hidrodrini.

Drejtori- sqaron se ka shpetu gabim teknik sepse behet fjale per Drinin e Bardhë

Mon Selmonaj- pyet, se a ka komision per mbikqyrje te punëve te rregullimi i projekteve te Lapidarve te deshmorve, qe vërteton se nje projekt eshte kryer plotësisht nga punekryesi.

Drejtori i Urbanizmit, Ramë Melaj- sqaron se sipas ligjit duhet te formohet komisioni per mbikqyrje te projekteve per te konstatuar realizimin e projektit, mirëpo ne në Komunë nuk kemi eksperta te shum fushave te ndërtimtarisë qe duhet ta bëjnë kete pune.

Albesa Cacaj- pyet, pse lejon komuna kur e bene mbikëqyrjen qe nje projekt mos te kontrollohet mire dhe pastaj na dalin punët e pa kryme mire, siç ka qene rasti me njoftimin qe ka bere Adem Lushaj per pikjen e Salles se sporteve.

Drejtori Urbanizmit- thot se kemi shum projekte ku financon Ministria siç eshte rasti edhe me Hallen e Sporteve dhe ata e bëjnë vet mbikëqyrjen dhe nuk na pyesin neve hiq.

Rekomandim; KPF e kanë shqyrtuar propozimin e ofruar për orientim të mjeteve dhe pas sqarimeve të dhëna nga drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa,z.Agron Demukaj, e përcjellin pa ndryshime për shqyrtim dhe marrje të vendimit në Kuvend, propozimin e Ekzekutivit me te hyrat vetanake te viti 2020 te bartura ne vitin 2021 ne shumën totale prej 112,165.58 €.

#### 4. Shqyrtimi i Raportit finanziarë për vitin 2020.

Kryesuesi- e ka prezantuar piken pastaj fjalën ia ka dhene drejtorit te buxhetit, i cili ka sqaruar se kemi inkasuar mbi 500,000 € te hyra ne vitin 2020, dhe kemi filluar me implementim te vendimit per inkasim te dhunshëm te tatimit ne prone ku si rezultat janë rritur te hyrat.

Albesa Cacaj- pyet se a do te bëni ndonjë lehtësim per shtresat e ulta per tatim ne prone.

Drejtori buxhetit- per gjigjet se per shtresat e ulta jemi duke u munduar qe te jau hjekim kamatën, shpenzimet po bëjmë përpjekje qe ti ulim ne minimum, poashtu njofton se me vendim te kryetarit janë anulu te gjitha vendimet dhe janë ndërpore te gjitha kontratat e punëtorëve te angazhuar ne pune te veçanta.

Valdet Nuraj- pyet se a jan ndërpore kontratat edhe ne QKMF.

Drejtori buxhetit- per gjigjet se ne shendetsi dhe e arsim nuk janë preke.

Valdet Nuraj- pyet sa eshte borgji i papaguar per punetoret e angazhuar me kontrate ne vepër.

Drejtori- per gjigjet se ne muajin e prillit do te jau bi gjendjen.

Rekomandim: antarët e KPF-së e shqyrtuan kete raport dhe shtruan nje varg pyetjesh, te cilave u eshte përgjigjur drejtori i buxhetit, poashtu drejtori ka njofuar se me vendim te kryetarit janë ndërpore te gjitha kontratat e poashtu janë terhjeke edhe te gjitha vendimet e punëtorëve me kontrate ne vepër, përjashtim bëjnë punëtorët e shëndetësisë dhe ata te arsimit .

Tema tjera të Rekomanduara nga KPF që të shqyrtohen në Kuvend:

#### 1.Rekomandimi i Komisionit per emrim të rrugëve.

Rekomandim:KPF kanë shqyrtuar edhe rekomandimin e komisionit per emrim te rrugëve:1.Rruga “Adem H. Zukaj” ne fshatin Beleg, dhe 2.Rruga “Rexhë Pajazitaj” ne fshatin Isniq.Anëtarët e KPF-së e kanë shqyrtuar rekomandimin e komisionit dhe kane bere disa vërejtje ne formën e prezentimit te materialit, mirëpo ne fund janë pajtuar qe materialin ta përcjellin per Kuvend, fillimisht duhet te hyn ne rend dite e pastaj per shqyrtim dhe miratim.

#### 2.Kërkesa e KF’DEÇANI”per përkrahje financiare ne vlere 7000 €.

Rekomandim:KPF e kane shqyrtuar kërkesën dhe kane bere kerkese qe te behet nje plan per përkrahje financiare te gjitha klubeve te sportit ne komunën tone dhe te vendosim sa mund ta mbështesim çdo njërin per tyre financiarisht.

Kerkesa e KF “Deçani” eshte mbështetur nga KPF dhe te njëjtën e përcjellin ne Kuvend, për arsyet që shuma e mjeteve të kërkua duhet të miratohet në Kuvend, atje debatohet prap dhe merret vendimi.

Me propozimin e drejtorit te drejtorisë për Urbanizëm dhe Rekomandim të KPF-së, për shqyrtim në kuvend janë edhe:

1. Shpallja e pronave me interes për nevojat e zgjerimit te rrugës në Qendër të qytetit, pjesë nga parcela nr.00933 shpallet me interes siperfaqja prej 212 m<sup>2</sup> dhe nga parcela nr.00931-2 shpallet me interes siperfaqja prej 16 m<sup>2</sup>, bazuar në elaboratin gjeodezik.

2. Rishpallja e pronave me interes, per nevojat e rregullimit te shtratit te lumit –Lumbardh i Deçanit, vendim i kuvendit i dt.30.11.2020, i cili kërkon edhe nje here votim ne kuvend dhe marrje te vendimit, për arsyet që tri prona atëherë ishin në hipotekë ndërsa tani janë larguar nga hipoteka.


1. Plani Lokal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për periudhën 2021-2025
2. Plani për Deponinë e Mbeturinave Inerte për Komunën e Deçanit.
3. Plani për Qendrën e Grumbullimit dhe Magazinimit të Mbeturinave të Vëllimshme.

Me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit dhe kërkesën e MAPL, kërkohet që këto tri akte të harmonizohen me dispozitat ligjore në fuqi, prandaj si të tilla edhe një herë duhet ti nënshtrohen procesit të votimit në Kuvend. KPF i Rekomandon Kuvendit qe të Ri- merret vendim për kë tri tema te miratuara ne kuvend me dt.28.12.2020.

Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse

Dyke Lolluni



Kryesuesi i KPF-së  
Haki Shehaj

